



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada –Government

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA**  
**MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**



**Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës**  
**Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services**  
**Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova**

## **Mbjellja e patates**

**Të nderuar fermerë,** jemi ende brenda afatit optimal për mbjelljen e patates. Ata që nuk kanë arritur ta mbjellin ende, mund të vazhdojnë procesin. Prandaj, po ju ofrojmë disa informacione të rëndësishme për të gjithë ata që kanë planifikuar mbjelljen e patates këtë vit.



**Patatja** dallohet me përshtatshmëri mjaft të mirë ndaj kushteve të ndryshme klimatike. Kjo mundëson kultivimin edhe në lartësi të ndryshme mbidetare. Mbirja fillon në temperaturë 7 deri 10 °C. Temperatura optimale e tokës për formimin e tuberëve është 16 – 18 °C. Ndërsa e ajrit 18 – 22 °C.

Përgatitja e tokës për mbjellje

**Lëvrimi i tokës**, përgatitja e shtretërve (rendet e ngritura), kanë për qëllim të:

- shpejtojnë mbirjen,
- depërtim të rrënjës në thellësi,
- drenim të mire,
- kontroll të barojave të këqija dhe
- shtresës mbuluese të dheut mbi tuberët e ri të kultivuar.

**Mbulimi i tuberëve** me shtrese të dheut parandalon: gjelbërimin, sulmimin nga insektet apo kërpudhat (p.sh. *Phytophthora infestans* – vrugu i patates) dhe rritjen sekondare të shkakuar nga ekspozimi në temperatura të larta.

Operacioni kryesor i lëvrimit të tokës me plug duhet të kryhet në thellësi prej 25-35 cm. Ky lëvrim do të:

- bëjë token e shkrifte,
- thyjë shtresat e papërshkueshme,
- përmirësojë drenimin,
- kthejë materien organike në tokë.
- Operacioni kryesor i lëvrimit të tokës është metoda me adekuate të kontrollit të barojave, sidomos kur ajo ekzekutohet me mjetet shtese për rrotullim të dheut (plugu imtësues, plugu disk).

Lëvrimi kryesor duhet të bëhet në vjeshtë. Përgatitja e shtretërve për farë duhet të kryhet pak para mbjelljes dhe duhet të bëhet atëherë kur toka nuk është e lagësht dhe as shumë e thate.

Lëvrimi i tokës me lagështi rezulton në kompaktësi të dheut dhe formim të grumbujve të dheut. Ngjeshja e dheut na shpie deri të drenazhimi i dobët dhe zhvillimi i sistemit të dobët rrënjor.



**Madhësia e tuberëve amë**, kultivari dhe zhvillimi i shkallës së mbishmërisë, të gjitha luajnë rol në zhvillimin e bimës së patates.

**Dendësia e mbjelljes** mund të shprehet si në ton/ha apo tuber/ha. Metoda më e sakte është caktimi i numrit të kërcjeve/ha.

**Për prodhimin e patates për konsum, numri i tuberëve për mbjellje** është zakonisht 40,000 tuberë/ha për t'i prodhuar kërcjet me një densitet prej 15-20 kërcje/m<sup>2</sup>.

Distanca në mes rreshtave varet shumë nga makineria e cila përdoret për mbjellje. Distanca që përdoret më së tepërmi është 70-75cm. Distancat më të vogla japin një mbulëse më të shpejtë dhe përdoren atëherë kur pritet rritje e vogël e kërcellit si dhe për mbjellje me dorë.

Distanca prej 90cm në mes rreshtave përdoret kur pritet rritje e madhe e kërcjeve dhe kualiteti i tuberëve është mjaft i rëndësishëm – mbushja e gjere e mbron kulturën nga ekspozimi në dritë të dielli (me ç'rast tuberët marrin ngjyrë të gjelbër), dëmtimi mekanik dhe rritja sekondare.

**Patatet duhet te mbjellën ashtu qe maja e tuberëve duhet** veç te mbulohet me dheun nëse mbushja e rendeve është nivelizuar drejtë. Me fjalë të tjera, tuberët janë afër 10 cm me poshtë se sa sipërfaqja (maja e rreshtave të patates) e mbathjeve.

Pasi qe çdo rregull ka përjashtime: Nëse ekziston rreziku nga përmbytja me ujë, atëherë tuberët duhet te mbjellën me larte apo nëse është rrezik nga thatësia atëherë ato duhet te mbillen me thellë.

Mbjellja e cekët mundëson vjelje më të lehte por shpie tek rritja e problemeve me baroja, dëmtime, vrugu i tuberëve dhe deformime.

Gjatë aplikimit të plehrave duhet pasur para sysh që për 10 ton/ha zhardhok, patatja thith nga toka 50 kg N, 25 kg P<sub>2</sub>O<sub>5</sub> dhe 79 kg K<sub>2</sub>O.

Ujitjet duhet të jenë sipas nevojës (varësisht nga të reshurat, tipi i tokës dhe faza e rritjes dhe zhvillimit të bimëve). Duhet pasur parasysh se kërkesat më të mëdha për lagështi janë në fazën e lulëzimit dhe formimit të tuberëve. Rreth 25 ditë para nxjerrjes së tuberëve duhet ndërprerë me ujitjet.



**Ku mund te merrni informata shtesë:**

Për informata shtesë mund te kontaktoni këshilltarët komunal ku ne secilën komune mund te lajmëroheni ne Drejtorinë - zyrën për bujqësi, ose ne zyrën qendrore te shërbimit këshillimor, si me poshtë;

**Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR**

**Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova**  
**Tel. 383- (0)3820038426**